



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPSTINA OPSTINE	
SKENDERAJ	
Nr.	
No.	01-112/010016143/25
Data.	
Data.	02.05.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), neni 35 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe neni 10 paragrafi 2 dhe 3 shkronja a), të Ligjit Nr.03/L-072 për zgjedhje lokale në Republikën e Kosovës, neni 3, 6 paragrafi 1 dhe neni 7 i Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d) neni 30 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Skenderajt me Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullte të mbajtur me datë 29.04.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Znj.Egzona Geci emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga subjekti politik "Lista e Pavarur Bekim Jashari "IDEAL" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Sala Jashari, po nga i njëjti subjekt politik.

Neni 2

Kompensimi mujor behet duke u mbështetur në Ligjin Nr. 08/L-196, për pagat në sektorin publik.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kompetentë është Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

A r s y e t i m

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shqyrtoj kërkesën e Kryesueses së Kuvendit të Komunës së Skenderajt të datë 03.04.2025, Nr.07/7/816/2025, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit znj.Sala Jashari, e cila ka dhënë dorëheqje për arsyeje të zgjedhjes deputete në kuvendin e republikës së Kosovës. Duke u bazuar në deklaratën e pranimi të mandatit të kandidatës së radhës sipas listës së renditur e cila është znj. Egzona Geci, nga i njëjti subjekte politik, dhe më numër me të madhe të votave, në bazë të rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve Lokale të vitit 2021, andaj me rastin e dhënies së betimit në Kuvendin e Komunës së Skenderaj, e pas plotësimit të gjitha kushteve ligjore nga KQZ-ja, emërohet anëtar si në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb-faqen e Komunës.


Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit.
- 1x1 Anëtares të emëruar;
- 1x1 Kryesueses;
- 1x1 MAPL-së;
- 1x1 Zyrës së Kryetarit.

KRYESUESAJ E KUVENDIT

znj. Adeline Spahiu





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 dhe nenin 3 paragrafi 3.2 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi c dhe 37 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3 dhe 5.1.9, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 03.04.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Anëtares të Kuvendit Komunal

- I. **Znj.Egzona Geci**, emërohet anëtare e kuvendit komunal në Skenderaj, nga subjekti politik "Lista e Pavarur Bekim Jashari", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal znj.Sala Jashari.
- II. **Obligohet** Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Egzona Geci dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 03.04.2025, Nr.07/7-816/2025, për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal znj.Sala Jashari, e cili ka dhënë dorëheqje për arsye të zgjedhjes deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur është znj.Egzona Geci. Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjta me numër më të madh të votave duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 03.04.2025

